

**VENDIM**  
**Nr.533, datë 1.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
PUBLIKE, SHETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,  
TË BASHKISË ERSEKË TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Ersekë të qarkut të Korçës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Ersekë të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.353, datë 20.5.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shetërore në bashkinë Ersekë, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Ersekë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Bashkia Ersekë

Lidhja nr. 1

| <b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b>                                                                                                                                                        | <b>Fusha e përdorimit të pronës</b>                                                         | <b>Lloji i transferimit</b> |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
| 1-11,493                                                                                                                                                                                                       | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës                     | Në pronësi                  |
| 19-26,61                                                                                                                                                                                                       | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore                                      | Në pronësi                  |
| 50-60,64                                                                                                                                                                                                       | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive                | Në pronësi                  |
| 98,99                                                                                                                                                                                                          | Varrezat publike                                                                            | Në pronësi                  |
| 336-338,340-346,348-350,<br>352-371,383,385-394,<br>396-404,406,408,410,412, 415,416,418-<br>420,423-427, 429,430,432-434,436-438,<br>441,442, 446-451,453-455,<br>457-460,462,463,465-469,<br>471-475,478-485 | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji | Në përdorim                 |
| 339,351,372-374,384,395,<br>405,407,409,411,413,414,<br>417,421,422,428,431,435, 440,443-<br>445,452,456,461, 464,470,476, (duke përfshirë sipërfaqet e kthyera)                                               | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji | Në përdorim                 |

|                                               |                                                                                                                                      |             |
|-----------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                               |                                                                                                                                      |             |
| 32,63,128-139,141-335,<br>375-382,408,416,494 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë<br>vendore, lulishte dhe shërbime<br>publike)                                                          | Në pronësi  |
| 62                                            | Prona që përdoren në fushën e<br>shërbimit social                                                                                    | Në pronësi  |
| 28-30,65-66,72-77,347                         | Prona që përdoren për ushtrimin e<br>funksioneve në fushën e zhvillimit<br>ekonomik                                                  | Në pronësi  |
| 79-97                                         | Prona që përdoren në fushën e<br>strehimit dhe të mbrojtjes civile                                                                   | Në pronësi  |
| 42,43                                         | Prona që përdoren për ushtrimin e<br>funksioneve në fushën e bujqësisë<br>dhe të ushqimit (toka produktive)                          | Në përdorim |
| 46,47,48,477                                  | Prona që përdoren për ushtrimin e<br>funksioneve në fushën e bujqësisë<br>dhe të ushqimit (kanale të treta dhe<br>toka joproduktive) | Në pronësi  |
| 31                                            | Prona që përdoren për ushtrimin e<br>funksioneve në fushën e ndriçimit<br>publik                                                     | Në pronësi  |